


Aksidentet Rrugore*

Qershor 2026

Në muajin qershor 2026 janë regjistruar 132 aksidente rrugore, në të cilat 186 persona kanë mbetur të aksidentuar (të vrarë dhe të plagosur).

Gjatë periudhës janar-qershor 2026, numri i aksidenteve rrugore ka pësuar rritje me 6,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

FIG. 1 AKSIDENTET RRUGORE DHE TË AKSIDENTUARIT (TË VRARË E TË PLAGOSUR), QERSHOR 2022 – QERSHOR 2026



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Illogaritjet INSTAT

Gjatë muajit qershor 2026, 93,9 % e aksidenteve rrugore kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve.

Grupmosha 35-44 vjeç paraqet numrin më të lartë të aksidenteve, duke përbërë 28,0 % të numrit total të aksidenteve të regjistruara në këtë periudhë.

* Të dhënat e publikuara janë paraprake dhe subjekt përditësimit.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore, sipas ditëve të javës, është shënuar ditën e martë me 18,9 %, ndërsa numri më i ulët është regjistruar ditën e enjte me 7,6 %.

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore është regjistruar përgjatë harkut kohor 19:00-24:00, duke përbërë 25,0 % të numrit total të aksidenteve rrugore.

TAB.1 AKSIDENTET RRUGORE, NUMRI I TË VDEKURVE DHE TË PLAGOSURVE, SIPAS QARQEVE

Periudha	Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur		Aksidente		Të vdekur dhe të plagosur	
	Qershor 2025	Qershor 2026	Qershor 2025	Qershor 2026	Janar-Qershor 2025	Janar-Qershor 2026	Janar-Qershor 2025	Janar-Qershor 2026
Shqipëria	107	132	140	186	636	679	883	952
Berat	3	0	4	0	14	3	16	3
Dibër	1	0	1	0	12	7	31	12
Durrës	8	21	15	24	49	59	67	86
Elbasan	5	2	5	3	29	23	36	36
Fier	7	13	10	21	54	46	81	62
Gjirokastrë	4	3	9	4	35	23	57	44
Korçë	15	12	15	20	60	45	66	53
Kukës	3	3	3	3	18	21	27	30
Lezhë	19	14	28	20	84	74	131	131
Shkodër	4	5	4	7	55	34	70	44
Tiranë	25	42	30	55	182	277	239	345
Vlorë	13	17	16	29	44	67	62	106

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT-it, në seksionin: [Transporti, Aksidentet dhe Karakteristikat e Mjetet Rrugore](#)

Metodologjia

Qëllimi i publikimit mujor të aksidenteve rrugore është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi aksidentet rrugore, si: ndryshimi në numrin e aksidenteve mujore, numrin e personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore, të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve në vend, duke i krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni që i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Përkufizime

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme, ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla, që sjellin pasoja të dëmshme.

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private, në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, dhe që rezulton në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person që ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, duke përjashtuar rastet e vetëvrasjeve.

I plagosur: Çdo person që, si rezultat i një aksidenti, nuk është vrarë menjëherë ose nuk ka vdekur brenda 30 ditëve, por ka pësuar një dëmtim për të cilin ka lindur nevoja për trajtim mjekësor, duke përjashtuar rastet e vetëvrasjeve në përprjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor”, si: frenim i papritur, mosrespektim i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektim i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor”, si: kalim rrugë pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Brendshme / Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Të dhënat e muajit të fundit mbi personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë informacion, referojuni te Politika e Revizionimit Statistikor.: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

- 0 - Vlerë më e vogël se gjysma e njësive matëse
- Pa vlerë
- (...) - Mungesë të dhënash